



Prishtinë, 24 qershor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_250_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 2 pika (h), Nenit 26 paragrafi 1 pika (a) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9, të amendimetuar me Ligjin Nr.03/L-080,
2. Dispozitat e Nenit 29 paragrafin 3 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizimin me Energji, dhe
3. Kërkesën për miratimin e Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike, të bërë me datë 02.04.2010 nga ndërmarrja e NQ "Termokos" SH.A., adresa: rruga "28 Nëntori", pn-Dardani/Prishtinë, Republika e Kosovës,

në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2010 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike për NQ Termokos SH.A.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 02.04.2010 ka pranuar kërkesën e të licencuarit-NQ Termokos SH.A. për miratim të Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike.
 2. Pas Shqyrtimit të kërkesës së NQ Termokos dhe plotësimit të Procedurës me komente shtesë, Bordi i ZRRE duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Procedurë në faqen e tij elektronike zyrtare.
 - III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të verzioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
 - IV. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

